

Për:	Operatorë Ekonomik: “Edibau–ing” SH.P.K. me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	13.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **12.04.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Edibau–ing” SH.P.K. me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QMF–ve DHE AMF–ve**, me Numër të prokurimit: **623-23-3034-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-030-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Edibau–ing” SH.P.K. me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QMF–ve DHE AMF–ve**, me Numër të prokurimit: **623-23-3034-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-030-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.04.2023**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QMF–ve DHE AMF–ve**, me Numër të prokurimit: **623-23-3034-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-030-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: “Edibau–ing” SH.P.K. me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RENOVIMI I QMF–ve DHE AMF–ve**, me Numër të prokurimit: **623-23-3034-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-030-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **03.04.2023**, të publikuar në ueb–faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **12.04.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

PRETENDIMI ANKIMOR:

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar, Bazuar në kriteret e vendosura mendojmë që i është përshtatur dikujt si kriter ose është vendosur gabimisht në doje pika.

1. 2.6. Një (1) punëtor të certifikuar si Moler, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;
2. 2.7 Një (1) punëtor të certifikuar si Suvatues, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;
3. 2.8 Një (1) punëtor të certifikuar si Murator, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;
4. 2.9 Një (1) punëtor Hidroinstalues, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;
5. 2.10. Një (1) punëtor të certifikuar si Instalues i ngrohjes qendrore, duhet të jenë të pajisur me diplomë përkatëse nga një Qendër e Aftësimit Profesional;

sepse ne si kompani kemi përfunduar projekte të natyrës së ngjashme me vlera edhe më të mëdha dhe nuk na është kërkuar ky kriter, për arsye se: Në rastë se kërkohet një Inxhinier i një fushe përkatese, nuk është e nevojshme të kërkohet edhe një punëtor i qertifikuar në Qendrën e Aftësimit Profesional. Në rastin më të thjeshtë ju në pikën 2.5 keni kërkuar një Inxhinier të Makineris i cili mundë te jetë (Master në programin Termoteknikë) dhe kjo menjëher bie ndesh me kërkesën tjetër të parashtruara në pikën 2.10 që kërkon një Instalues të ngrohjes qendrore. Sipas gjykimit të drejtë një Diplomë Inxhinieri e mbulon kërkesën për një punëtor të thjeshtë, gjë që bie në kundërshtim me pikat e cekura më lartë.

6. Në kuandër të stafit Professioanl
7. Në Kërkesa 1 Numri i Punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min 10 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemri, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vitet) dhe pozicioni në kompani

3/7

Ne kuandër të kësaj kërkesë ju si Autoritet Kontraktues keni kërkuar që tek Lista e punëtorëve të ceket edhe profesioni i punëtorit, i cili mundë të jetë Moler, Suvatues etj...

Komisioni Rregullativ i Prokurimit me date 22.11.2019 ka nxjerrur vendim për vendosjen e kriterëve diskriminues gjatë publikimit të njoftimeve për kontratë.

Ne përputhje me paragrafin 1 të nenit 51 të LPP-se Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktojë Kriteret e për zgjedhjes në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin e Kontrates që një OE duhet të plotësojë për të konsideruar i përgjegjshëm. Të gjitha kriteret e për zgjedhura duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për të përmbushur kushtet e kontratës përkatëse.

Kërkojmë edhe njëherë rishikim të pikave të cekura më lartë.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE:

Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmive është kujdesur që në maksimum të respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabartë dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi në pajtueshmëri me objektin e kontratës. Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik ku ka kërkuar kualifikimet shkollore Stafin profesional (inxhinierët) e domosdoshëm për implementimin e këtij projekti si dhe punëtorët (stafin teknik) të domosdoshëm për implementim të këtij projekti.

Si rrjedhojë një inxhinier nuk mund ta mbulojë punën e një punëtori teknik dhe e kundërta.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit